



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2141, datë 16.08.2012

Për

Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 16.08.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. – Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti Ushtarak 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 88, neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 për “*Portabilitetin e numrit*” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.1219, datë 07.04.2010, ndryshuar me VKD nr. 1530, dt. 18.3.2011, ndryshuar me VKD nr. 1776, dt 20.2.2012.
4. Rregullore nr. 18 “*Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**)”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008,

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. me nr. 1455Prot., datë 20.07.2012, “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me procesin e portimit të subjekteve Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti 1050, nga operatori Vodafone Albania sh.a. në operatorin Eagle Mobile sh.a.*”
- Shkresa e Eagle Mobile sh.a. nr. 1455/1Prot., datë 30.7.2012, (nr. 1594Prot. i AKEP, datë 31.7.2012) “*Plotësim i kërkesës së Eagle Mobile sh.a. nr. 1455Prot., datë 20.07.2012, “Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me procesin e portimit të subjekteve Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti 1050, nga operatori Vodafone Albania sh.a. në operatorin Eagle Mobile sh.a.”;*
- Korrespondenca me postë elektronike (email) e shkëmbyer mes palëve,
- Procesverbali i takimit mes palëve Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., mbajtur me datë 25.7.2012, ora 10:00, në ambientet në AKEP,
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**),
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Eagle Mobile sh.a., me shkresën nr. 1455Prot., datë 20.07.2012, “*Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me procesin e portimit të subjekteve Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti 1050, nga operatori Vodafone Albania sh.a. në operatorin Eagle Mobile sh.a.*”, sqaron si më poshtë:

Eagle Mobile sh.a., shpjegon se bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 120 dhe në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, neni 46, 66, dhe Rregullores së Portabilitetit të Numrit, neni 17, paraqet kërkesë për ndërhyrjen e AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile dhe Vodafone Albania, për procesin e portimit të subjekteve Reparti Ushtarak 1040 dhe Reparti 1050, nga operatori Vodafone Albania sh.a. në operatorin Eagle Mobile sh.a.

Eagle Mobile sqaron se gjatë këtij procesi Vodafone ka shkelur vazhdimisht Rregulloren e Portabilitetit duke dëmtuar pajtimtarët të cilët vazhdojnë të jenë pa shërbim prej datës 12.7.2012.

Në lidhje me Repartin Ushtarak 1050

Kërkesa e parë për portim e numrave është bërë më datë 11.7.2012, dhe Vodafone ka refuzuar me përgjigjen “*Name and surname does not match*”. Pasi është ridërguar kërkesa ajo është refuzuar me arsyen “*Number not located in donor network*”. Eagle Mobile sqaron se në kohën kur ka filluar procesi i portimit numrat kanë qenë aktivë. Më pas kërkesa e dytë është refuzuar për arsye “*Number not located in donor network*”, kjo do të thotë që numrat janë ç’aktivizuar pas fillimit të procesit të portimit.

Procesi i portimit të këtyre numrave ka filluar më datë 11.7.2012, dhe prej kësaj date Vodafone në zbatim të Rregullores së Portabilitetit duhet të vazhonte procesin e portimit dhe jo të mbyllte numrat (në kundërshtim me afatet e përcaktuara në kontratën e pajtimtarit) për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve.

Vodafone ka vonuar procesin e portimit të këtyre numrave tej afateve të përcaktuara në rregullore sipas nenit 15/3.

Në rastin konkret procesi i portimit është vonuar edhe për arsyen “*NIPT doesn't match with donor database*”. Vodafone i ka regjistruar këto subjekte me NIPT të ndryshëm nga NIPTI që subjekti ka. Në të njëjtën kohë Vodafone nuk e paraqet në faturën e subjektit NIPT-in e regjistruar në të dhënat e veta. Në këtë mënyrë vonohet procesi, pasi operatori marrës nuk ka asnjë mënyrë se si të ketë dijeni mbi NIPT-in që Vodafone regjistron në të dhënat e tij subjektet.

Më datë 19.7.2012, Eagle Mobile është njoftuar me shkresë zyrtare nga Reparti 1050, se numrat e mbyllur nga Vodafone kanë qenë të aktivizuar deri në datën 12.7.2012, dhe se Vodafone ka njoftuar me shkresë jozyrtare Repartin 1050 me datë 7.7.2012, mbërritur në Repart më datë 10.7.2012, për mbyllje numrash për detyrime të prapambetura pas një afati 5 ditor.

Në lidhje me Repartin Ushtarak 1040

Kërkesa e parë për portim është bërë në datë 11.7.2012, dhe Vodafone ka refuzuar me arsyen “*NIPT does not match*”.

Eagle Mobile shpjegon se në kohën e fillimit të procesit të portimit numrat kanë qenë aktivë. Më pas kërkesa e dytë port-in është refuzuar me arsyen “*Number not located in*

donor network”, që do të thotë se numrat janë ç’aktivizuar pas fillimit të procesit të portimit.

Procesi i portimit për këta numra ka filluar me datë 11.7.2012 dhe prej kësaj date Vodafone në zbatim të rregullores duhet të vazhdojë me procesin e portimit dhe jo të mbyllte numrat në kundërshtim me afatet e përcaktuara në kontratën e pajtimtarit për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve.

Vodafone e ka vonuar procesin e portimit të këtyre numrave tej afateve të përcaktuara në rregullore sipas nenit 15/3.

Edhe në këtë rast Vodafone ka vonuar procesin me arsyen “*NIPT doesn’t match with donor database*”. Vodafone i ka regjistruar këto subjekte me NIPT të ndryshëm nga NIPTI që subjekti ka. Përsëri Vodafone nuk e paraqet në faturën e subjektit NIPT-in e regjistruar në të dhënat e veta. Në këtë mënyrë vonohet procesi, pasi operatori marrës nuk ka asnjë mënyrë se si të ketë dijeni mbi NIPT-in që Vodafone regjistron në të dhënat e tij subjektet.

Më datë 19.7.2012, Eagle Mobile është njoftuar me shkresë zyrtare nga Reparti 1040, se numrat e mbyllur nga Vodafone kanë qenë të aktivizuar deri në datën 12.7.2012, dhe se Vodafone ka njoftuar me shkresë jozyrtare Repartin 1040 me datë 7.7.2012, mbërritur në Repart më datë 10.7.2012, për mbyllje numrash për detyrime të prapambetura pas një afati 5 ditor.

Reparti Ushtarak informon se Vodafone ka mbyllur edhe numra të cilët kanë lidhur kontratë pajtimtari me Vodafone 3 muajt e fundit (në kundërshtim me afatet e njoftimit për zgjidhje kontrate nga operatori).

Megjithëse palë e tretë në marrëdhënien midis Vodafone dhe pajtimtarit, Eagle Mobile ngre këtë shqetësim në AKEP si palë e interesuar (si operator marrës) sepse shkeljet e kontratës së pajtimtarit nga Vodafone kanë influencuar direkt tek Eagle Mobile dhe pajtimtarët të cilët nuk kanë shërbim telefonik prej datës 12.7.2012.

Eagle Mobile sqaron se linjat që i përkasin Reparteve Ushtarake 1050 dhe 1040, bëjnë pjesë tek Reparti Ushtarak 1001 i Forcave të Armatosura, procesi i portimit për të cilët ka përfunduar suksesshëm më datë 13.7.2012. Duke qenë pjesë e të njëjtit institucion procesi i portimit duhet të vazhdojë si një i tërë dhe të mos ndërpritej në kundërshtim me Rregulloren e Portabilitetit, për arsye të detyrimeve kontraktore duke dëmtuar së pari pajtimtarët.

Në përfundim Eagle Mobile kërkon:

1. Hapjen e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes Eagle Mobile dhe Vodafone në lidhje me shkeljen e Rregullores së Portabilitetit të Numrit nga ana e Vodafone gjatë procesit të portimit të subjekteve Reparti Ushtarak nr. 1040 dhe 1050.
2. Ndërhyrjen sa më të shpejtë nga ana e AKEP për zgjidhjen e kësaj situatë në interes të pajtimtarit, hapjen e shërbimit për të dhe marrjen e masave të caktuara për moszbatimin nga ana e Vodafone të Rregullores së Portabilitetit të Numrit.

II. Nga ana e Vodafone Albania, në korrespondencën me email është shpjeguar se:

Vodafone ka përfunduar zyrtarisht kontratën e pajtimtarit me Repartin Ushtarak 1040, bazuar në *“Kushtet e përgjithshme për ofrimin e shërbimit të telefonisë celulare”* përpara kërkesës për portim nga Eagle Mobile.

Sa më sipër Vodafone ka sqaruar se ka vepruar në përputhje me nenin 15/2/c/cc, të Rregullores së Portabilitetit. Vodafone sqaron se nuk mund t'i vërë në dispozicion dokumentin e përfundimit të kontratës duke qenë pjesë e marrëdhënies mes Vodafone dhe pajtimtarit, dhe nuk është e detyrueshme sipas rregullores së sipërpërmendur.

Me email të datës 24.7.2012, Vodafone është shprehur se respekton parimet e portabilitetit të numrit dhe se ka vepruar në përputhje me *“Rregulloren e portabilitetit të numrit”* sa i takon numrave të Reparteve Ushtarakë 1040 dhe 1050.

Vodafone nuk e ka ndërprerë procesin e bartjes sipas çdo kërkesë për bartje, por duke qenë se pajtimtari mund të kërkojë bartje të një pjese të numrave të tij drejt një operatori tjetër, pajtimtari mbetet klient i operatorit dhënës për ato numra që nuk kanë qenë subjekt i kërkesës për bartje, deri në momentin që vjen një e tillë.

Për numrat që kanë qenë subjekt i një kërkesë të tillë dhe kur të gjithë elementët e identifikimit të pajtimtarit kanë qenë të saktë, Vodafone ka pranuar dhe proceduar me bartjen e ketyre numrave. Nga ana tjetër, kjo kërkesë nuk e pengon Vodafone të zgjidhë kontratën me pajtimtarin për numrat që kanë ngelur në rrjetin e Vodafone, për arsye të parashikuara në Ligjin nr. 9918, dhe në *“Kontratën me pajtimtarin”* në përputhje me procedurat dhe afatet e parashikuara në të.

Vodafone ka zbatuar Rregulloren për Portabilitetin e Numrit dhe refuzimi për të bartur disa numra të Reparteve Ushtarake 1040 dhe 1050, bazohet në arsyen se këto numra nuk ekzistojnë më në rrjetin e Vodafone.

Vodafone thekson se zgjidhja e kontratës është bërë në të drejtën e plotë të Vodafone dhe në përputhje me procedurën dhe afatet e parashikuara në kontratën e pajtimtarit. Eagle Mobile nuk mund të pretendojë e as të detyrojë Vodafone Albania në lidhje me përfundimin e kontratës së Vodafone me klientin për sa kohë që kjo marrëdhënie civile rregullohet me ligj nr. 9918, dhe Kontrata e pajtimtarit. Pretendimet e Eagle Mobile shkojnë përtej çdo koncepti e parimi të zbatimit të ligjit.

III. Më datë 25.7.2012, ora 10:00 AKEP ftoi palët Eagle Mobile dhe Vodafone Albania, në takim në ambientet e tij me qëllim degjimin e palëve për çështjen objekt i mosmarrëveshjes. Edhe në këtë takim palët mbajtën të njëjtat qëndrime sa i takon çështjes së portimit të numrave të Reparteve Ushtarake 1040 dhe 1050, duke mos rënë dakord.

IV. Sa më sipër, duke qenë se sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. megjithë përpjekjet e bëra edhe me ndërhyrjen e AKEP, nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, për sa i takon procesit të portimit të numrave celularë të mbajtur nga Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050, nga Vodafone tek Eagle Mobile, AKEP, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”*, zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në

rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., në lidhje me procesin e portimit të numrave celularë të mbajtur nga Repartet Ushtarake 1040 dhe 1050, nga Vodafone Albania sh.a. tek Eagle Mobile sh.a.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Jetmir Braha Anëtar
 - Donald Shtrepi Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Eagle Mobile sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE